

Promovimi i lidershipit dhe i pjesëmarrjes së grave në zgjedhjet e ardhshme politike është thelbësore për Shqipërinë

Datë: 8 mars 2025

Zgjedhjet e përgjithshme të 11 majit 2025 janë një mundësi e rëndësishme për të forcuar demokracinë në Shqipëri dhe për të konsoliduar arritjet e mëparshme në avancimin e lidershipit të grave në vendimmarrje. Ndërkohë që Shqipëria ka bërë përparim të jashtëzakonshëm në promovimin e pjesëmarrjes së grave në politikë në nivel qendror, - rezultate të njohura nga komuniteti ndërkombëtar dhe mekanizmat e të drejtave të njeriut – përsëri ka sfida. Sipas renditjes së vitit 2025 të Unionit Ndërparlamentar, Shqipëria aktualisht mban pozicionin e 44-të në shkallë globale për sa i përket numrit të grave në parlament.¹ Megjithatë, ruajtja dhe zgjerimi i këtyre arritjeve kërkon masa shtesë për të siguruar pjesëmarrje domethënëse, për të parandaluar kthimin mbrapsht dhe për të nxitur një progres më të madh.

Përpara fushatës, dhe para se listat e kandidatëve të finalizohen, Kombet e Bashkuara në Shqipëri janë angazhuar me parti politike dhe aktorë të tjerë, duke advokuar për pjesëmarrje të plotë dhe me ndikim të grave në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare dhe duke paraqitur një sërë rekomandimesh në pesë fusha kyçe.

1. Zbatimi dhe tejkalmi i kuotave gjinore

OKB-ja u kërkon partive politike që të ruajnë me rigorozitet kuotën gjinore prej 30% në listat shumëemërore (si në listat e mbyllura ashtu edhe në votimin preferencial), siç kërkohet nga Kodi Zgjedhor.² Megjithatë, Shqipëria ka potencialin të tejkalojë kuotat minimale dhe të shkojë drejt përfaqësimit të barabartë (barazi 50/50) të grave dhe burrave në vendimmarrje.

Arritja e diversitetit të vërtetë në lidhje me aksesin e barabartë dhe fuqinë e barabartë brenda sistemeve vendimmarrëse është thelbësore.³ Grupe të caktuara të grave mbeten sistematikisht të përjashtuara nga proceset politike, për shkak të mungesës së mundësive. Partitë politike duhet të sigurojnë pjesëmarrjen e të gjitha grave, përfshirë ato nga grupet e nënpërfaqësuar - të tilla si gratë me aftësi të kufizuara, gratë rome dhe egjiptiane, gratë e reja dhe gratë në zonat rurale. Kjo përputhet me angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë në kuadër të CEDAW, Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) dhe Ligjit për Barazinë Gjinore (LBGJ).

2. Sigurimi i mbështetjes së partive politike për gratë kandidate

Mbështetja e fortë nga udhëheqja e partisë është thelbësore për pjesëmarrjen domethënëse të grave në politikë - jo sepse gratë nuk janë të afta për të fituar zgjedhjet, por sepse vazhdojnë pengesat sistematike gjinore në një fushë të dominuar tradicionalisht nga burrat. Partitë politike

¹ IPU (2025), Renditja mujore e grave në parlamentet kombëtare

² Shih amendimet e vitit 2024 në Kodin Zgjedhor, https://data.ipu.org/women-ranking/?date_year=2025&date_month=01

³ Komiteti i CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 40 (2024)

duhet të promovojnë në mënyrë aktive gratë kandidatë duke siguruar (i) akses të barabartë në burimet e fushatës, në trajnimin në fushën politike⁴, dhe në mundësitë për leadership; (ii) monitorim të brendshëm dhe mekanizma të llogaridhënies për të gjurmuar progresin në barazinë gjinore (iii) avancim të drejtë brenda strukturave partiake mbi bazë të meritave, pa paragjykime gjinore dhe me rregullime të nevojshme për balancimin e punës dhe jetës.

3. Adresimi i pabarazive financiare në financimin e fushatës

Trajtimi i barabartë financiar është shumë i rëndësishëm për gratë kandidatë. Kodi zgjedhor shqiptar nuk rregullon shpërndarjen e brendshme financiare të fondeve publike ose fondeve të tjera private midis kandidatëve të partisë duke i lënë gratë në disavantazh. Shumë gra kandidatë nuk kanë akses të barabartë në fondet e fushatës për shkak të pengesave strukturore dhe stereotipeve gjinore për ngritjen dhe mbledhjen e fondeve. Për të parandaluar diskriminimin financiar, partitë politike duhet (i) të miratojnë rregullore të brendshme që garantojnë akses të barabartë në fondet e fushatës për gratë kandidatë⁵ dhe (ii) të sigurojnë transparencë të plotë në shpërndarjen e fondeve brenda partive.

4. Lufta kundër paragjykimeve gjinore, ngacmimeve dhe dhunës në politikë

Gratë kandidatë përballen me nivele joproporcionale të ngacmimeve dhe paragjykimeve si brenda partive politike ashtu edhe në media. Partitë politike nuk duhet të tolerojnë përdorimin e gjuhës përçmuese, stereotipeve gjinore dhe çfarëdolloj forme të dhunës me bazë gjinore në zgjedhje kundër kundërshtareve gra (dhe burra). Këto çështje përkeqësohen më tej nga mediat (në internet dhe mediat sociale). Një raport i [UN Women](#) i vitit 2021 për monitorimin e medias zbuloi se mediat tradicionale dhe mediat sociale dëmtonin vazhdimisht kandidatet gra në zgjedhjet e përgjithshme të Shqipërisë. Përveç kësaj, një studim i kryer nga PNUD ([a study conducted by UNDP](#)) konfirmoi se gratë politike kanë më shumë gjasa se burrat të përjetojnë dhunë psikologjike. Organet e të drejtave të njeriut i kanë bërë thirrje Shqipërisë (i) të forcojë mekanizmat për të parandaluar gjuhën e urrejtjes, ngacmimet dhe kërcënimet ndaj grave kandidatë, (ii) t'u kërkojë partive politike të miratojnë Kodin e Etikës për të promovuar barazinë gjinore dhe për të luftuar ngacmimin, (iii) t'i bëjë kompanitë e mediave sociale përgjegjëse për përmbajtjen diskriminuese të krijuar nga përdoruesit.ⁱⁱ Mediat dhe Autoriteti i Medias Audiovizive duhet të luajnë një rol aktiv në sigurimin e mbulimit të barabartë në media dhe eliminimin e gjuhës seksiste.

5. Rritja e pjesëmarrjes së grave në zgjedhje dhe në ndikimin zgjedhor

Partitë politike duhet të angazhojnë si burrat ashtu edhe gratë në mënyrë të barabartë, duke pranuar se gratë përbëjnë një pjesë të madhe të elektoratit. Në zgjedhjet kombëtare të vitit 2021, gratë përbënin 48.07% të totalit të zgjedhësve, megjithatë vetëm 44.99% e grave me të drejtë vote morën pjesë në zgjedhje. Kjo pjesëmarrje më e ulët mund të mos tregojë mungesën e

⁴ Një nga rekomandimet e Komitetit të CEDAW: Komiteti i CEDAW (2023), Vëzhgimet përmbyllëse mbi raportin e pestë periodik të Shqipërisë

⁵ Po aty

interesit në politikë, por tregon më shumë pengesa sistematike ndaj pjesëmarrjes, si dhe shqetësime për sigurinë. Për të trajtuar këtë problematikë, partitë politike duhet (i) të përgatitin programe zgjedhore të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore që përfshijnë adresimin e sfidave dhe prioritetëve të grave dhe vajzave nga të gjitha shtresat social-ekonomike (ii) të sigurojnë që gratë të mund të votojnë lirisht, pa detyrim, pa frikësime dhe praktika të votimit familjar.

Në nivel global, si dhe në Shqipëri, gratë kanë luftuar - dhe kanë fituar - të drejtën për të votuar, për të punuar, për të udhëhequr. Dita ndërkombëtare e gruas këtë vit shënon 30 vjet nga konferenca historike botërore për gratë dhe plani i veprimit që doli nga Samiti i Pekinit, ku bota bëri një premtim: të drejtat e grave janë të drejta të njeriut. Zgjedhjet e ardhshme parlamentare janë një mundësi për të treguar vendosmërinë e vendit për të mos u larguar nga barazia gjinore, por për të ecur përpara për të gjitha gratë dhe vajzat.

Sigurimi i pjesëmarrjes së plotë të grave në politikë nuk është vetëm një çështje e grave: është një imperativ shoqëror dhe demokratik! Avancimi i lidershit të grave në vendimmarrje dhe organet e zgjedhura është thelbësore për zhvillimin demokratik të Shqipërisë dhe përparimin drejt Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Gratë dhe burrat njëlloj duhet të hedhin poshtë kuptimin për gratë si spektatore pasive dhe të punojnë së bashku për të krijuar një sistem politik të ndërtuar mbi bazën e mundësive të barabarta. Duke mbështetur dhe çuar përpara konceptin për gratë në vendimmarrje, ne kontribuojmë në mënyrë aktive për një vend më të drejtë dhe më të barabartë për të gjithë shqiptarët.

Fiona McCluney, Përfaqësuese e OKB-së në Shqipëri
Michele Ribotta, Drejtues i Grupit të OKB-së për barazinë gjinore